



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202201154/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër.

**Drejtuar:** znj. Reme LALA  
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

**TIRANË**

**Për dënim:** z. Fatjon HOXHA  
Drejtor i Shtëpisë së të Moshuarve

**SHKODËR**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër.

Inspektimi u krye në datën 15.09.2022, sipas një Plani Inspektimi vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda dhe znj. Gloria Çarkaxhiu, nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre. Mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimit të forcës tej kufijve në tejkalim të standardeve.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t'Ju parashtrijë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon:

### **Objektivat e inspektimit:**

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2021 si dhe gjendja aktuale,
- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi,
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

### **Metodologjia**

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, si metodologji pune ka përdorur:

- **Së pari**, zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesin e institucionit dhe përgjegjësën e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- **Së dyti**, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- **Së treti**, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve, Shkodër), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- **Së katërti**, komunikimi me të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve, Shkodër.

Grupi inspektimit, gjatë vizitës kërkoi të informohet në veçanti mbi takimet me familjarët dhe aktivitetet që organizoheshin për të moshuarit e akomoduar në këtë qendër. Në vijim konstatuam që Shtëpia e të Moshuarve Shkodër i ishte rikthyer normalitetit, duke lejuar të moshuarit të takoheshin me familjarët gjithmonë në prezencën e kujdestarit duke ruajtur intimitetin e takimit.

Aktivitetet zhvilloheshin normalisht, artistë e të ftuar vinin dhe vizitonin të moshuarit duke krijuar një atmosferë ndryshe, ndërkohë që organizoheshin dhe ekskursione në qytete të ndryshme të cilat dhe i pasqyronin në faqen e tyre në rrjete sociale.

Ju bëjmë me dije së, nga inspektimi i mëparshëm i kryer më datë 01.10.2021 në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër<sup>1</sup>, për problemet e konstatuara u rekomandua Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë së shtëpisë së të Moshuar Shkodër sa më poshtë:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë, me formim infermieri.
2. Marrjen e masave për shtim në organikë të pozicionit të punës me psikolog ose animator me kohë të pjesshme.
3. Marrjen e masave për shtesë në pagë sipas vështirësisë, për kategorinë e personelit, që kujdeset për kategorinë e të moshuarve me probleme të shëndetit mendor.

---

<sup>1</sup> Rekomandimi i institucionit të Avokatit të Popullit dërguar institucioneve përgjegjëse

4. Marrjen e masave për mundësimin e vendosjes së një automjeti në shërbim të të moshuarëve për raste emergjente, si dhe transportin e tyre për vizita mjekësore apo aktivitete të ndryshme
5. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë, të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Shërbimi Social Shtetëror<sup>2</sup> ka informuar:

- *Për rekomandimin nr.1*, duke qenë se në strukturën sipas Urdhërit nr.88 datë 25.10.2011 “Për ndryshimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror”, nuk është e përcaktuar që kujdestarët të kenë formim infermierie, në shpalljet publike të vendeve të reja të punës në këtë pozicion, do të përcaktohet kriteri niveli arsimor i infermierisë.
- *Për rekomandimin nr.2*, nuk është përcjellë shkresë nga Shtëpia e të Moshuarëve, Shkodër për nevojën e një psikologu. Aktualisht ata e marrin këtë shërbim nga psikologë të punësuar pranë Qendrës Shëndetësore në qytetin e Shkodrës.
- *Për rekomandimin nr.3*, pagat e punonjësve janë të përcaktuara me VKM nr.187 datë 08.03.2017”Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të Nëpunësve Civilë,/Nëpunësve, Zëvendësministrit dhe Nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparate e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të Pavarura, Institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në varësi të Ministrave të Linjës dhe administratën e Prefektit”.
- *Për rekomandimin nr.4*, nuk ka automjet, në zbatim të ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”. Shërbimi shëndetësor ofrohet nga mjeku, i cili është punësuar me kohë të pjesshme.
- *Për rekomandimin nr.5*, përsa i përket të moshuarëve që shfaqin probleme shëndetësore trajtohen si nga mjeku dhe stafi social i institucionit me terapi të veçanta mjekësore dhe sociale.

Avokati i Popullit konstaton se përgjigjet e Shërbimit Social Shtetëror tregojnë bashkëpunim në lidhje me përmirësimin e kushteve sipas rekomandimeve. Ndërkohë është i qartë fakti që organika e qendrës miratohet me VKM, por do duhet të paraqesin kërkesë të ndryshojnë këtë VKM duke qenë autoriteti propozues.

Në shtëpisë së të Moshuar Shkodër, nga informacioni i grumbulluar gjatë kryerjes së inspektimit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021 rezultojnë se:

- Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi përkatës për shtim në organikë të pozicionit të punës, me një infermier me kohë të pjesshme.

---

<sup>2</sup> Shkresa me nr. 2362/1 prot., date 07.01.2022.

- Ishe zbatuar rekomandimi për shtim në organikë të pozicionit të punës me një animator me kohë të pjesshme.

Nga informacioni, rezultoi se nuk kishte gjetur zbatim asnjë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit të lëna në inspektimin e mëparshëm:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi për shtesë në pagë sipas vështirësisë, për kategorinë e personelit, që kujdeset për kategorinë e të moshuarve me probleme të shëndetit mendor.
2. Marrjen e masave për mundësimin e vendosjes së një automjeti në shërbim të të moshuarve për raste emergjente, si dhe transportin e tyre për vizita mjekësore apo aktivitete të ndryshme
3. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë, të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

### **Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit** ***Profili i Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër.***

Shtëpia e të Moshuarve Shkodër, është një institucion publik rezidencial, ku trajtohen persona të moshuar, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Misioni i këtij institucioni është që të ofrojë ndihmë dhe shërbime sociale të qëndrueshme dhe me standarde bashkëkohore, me qëllim që të nxitet pavarësia dhe integrimi i të moshuarve në jetën normale, duke bashkëpunuar me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin, me synim plotësimin e nevojave sociale dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve.

Ky institucion është nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror. Mbështetja financiare është e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror.

Shtëpia e të Moshuarve, Shkodër, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar dhe të braktisur, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni, së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të tij, e cila është e afishuar në ambientet e institucionit. Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdueshëm, monitorohet nga vetë institucioni, me pyetësorë lidhur me cilësinë e shërbimeve; nga Shërbimi Social Shtetëror; Drejtoria Rajonale e SHSSH-së, Shkodër; nga inspektimet e kryera të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Institutit të Higjienës, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit etj.

#### ***-Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara***

Në këtë qendër strehohen të moshuar duke filluar që nga mosha 55 vjeç, por ka dhe përfitues të tjerë, të cilët vijnë si raste emergjente. Aktualisht strehoheshin 55 të moshuar

ndërkohë që kapaciteti i kësaj qendre është prej 65 personash. Nga këta, 20 persona janë me probleme të rënda shëndetësore, prapambetje mendore, të sëmurë paraplegjikë e tetraplegjikë, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë. Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan për kujdesin shëndetësor, sipas nevojave specifike për secilin të moshuar, bazuar në kartelën shëndetësore, e cila mbahet të mjeku i familjes. Plani i kujdesit shëndetësor hartohet çdo muaj nga mjeku, e cila prej vitesh punon me kohë të pjesshme në këtë institucion, e cila çdo ditë i takon të moshuarit, i mat tension dhe bisedon me ta për çdo problem që ata i shqetëson. Të gjithë të moshuarit dhe stafi në këtë qendër ishin të vaksinuar me dy doza të vaksinës anti-covid. Gjithashtu të gjithë të moshuarit kishin të pasqyruar në kartelat e tyre dhe analizat klinike dhe biokimike.

Numri i përfituesve përgjithësisht ndryshon në varësi të transferimeve në institucione të tjera rezidenciale sipas kërkesave të të moshuarve, raste të humbjes së jetës, raste emergjente për strehim dhe kapacitet për të akomoduarit autosuficient dhe jo autosuficient.

Kartelat mjekësore mbahen pranë Qendrës Shëndetësore që mbulon edhe këtë institucion rezidencial, të cilat tërhiqen kur të moshuarit paraqesin probleme shëndetësore nga mjekja me kohë të pjesshme, e cila është dhe mjeke e asaj qendre.

Medikamentet, me të cilat trajtohen të moshuarit janë të rimbursueshme dhe u jepen rregullisht. Furnizimi bëhet 1 herë në vit dhe është i mjaftueshëm sipas kërkesave të të moshuarve. Institucioni, me shpenzimet e veta, u ofron të moshuarve medikamente, sipas nevojave të tyre specifike që ato mund të paraqesin gjatë vitit.

Një pjesë e medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbulohej nga vetë të moshuarit. Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit. Vetëm vizitat dentare bëheshin falas.

Plani i përkujdesit për të moshuarit hartohet çdo vit, ndërsa rishikohej ecuria i të moshuarit çdo 6 muaj. Nëse konstatoheshin probleme më specifike, plani i përkujdesjes rishikohej edhe më herët.

Në vijim, grupi i punës konstatoi se në farmaci kishte disa ilace të cilat kishin skaduar rishtazi (deri në tre muaj më parë). Ky fakt ju bë me dije si mjekut ashtu dhe drejtuesit të institucionit të cilëve ju kërkua nisja e menjëhershme e procedurës për asgjësimin e tyre.

Numri i personave të cilët përfitojnë pension pleqërie është 46, nga i cili 60% ju jepet vetë personave ndërkohë që 40% shkon në buxhetin e shtetit<sup>3</sup>.

### ***Burimet njerëzore***

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 23 punonjës me kohë të plotë, si dhe 1(një) mjek me kohë të pjesshme dhe 1 (një) sanitare me kohë të pjesshme, 1 nje ndihmës guzhinere me kohë të pjesshme dhe 1 një infermier me kohë të pjesshme.

---

<sup>3</sup> Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr.898, datë 10.11.2010, "Për disa ndryshime në Vendimin nr.114, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e masës së kontributeve të personave që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror"

Gjatë turnit të parë punojnë 3(tre) kujdestare dhe 2(dy) sanitare dhe 1 një roje

Gjatë turnit të dytë punojnë 1(një) kujdestare dhe 1(një) sanitare dhe një roje

Gjatë turnit të tretë punon 1(një) kujdestare dhe 1(një) sanitare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale.

Shërbimi mjekësor realizohet nga një mjek me kohë të pjesshme. Plani individual shëndetësor për përfituesit pasqyrohet në kartelat e tyre personale. Shërbimi dentar kryhet në klinikat private, me shpenzimet e të moshuarve.

Kopjet e dosjeve të personelit mbahen në institucion, pasi dosjet origjinale ndodhen pranë Shërbimit Social Shtetëror. Përshkrimi i punës për personelin pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme të Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër.

Vlerësimi i punës së tyre bëhet çdo vit nga drejtuesi i institucionit dhe të gjitha vlerësimet dërgohen pranë Shërbimit Social Shtetëror, ndërsa një kopje e tyre mbahet në institucion.

Stafi është trajnuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Gjatë periudhës së pandemisë janë organizuar trajnime online për shëndetin mendor dhe asistencë psikologjike për personelin, të cilët kanë qëndruar në karantinë me të moshuarit.

Për ruajtjen e objektit, janë punësuar dy roje, të cilët punojnë në fashat e orareve: 6:00-12:00 dhe 15:00-20:00

#### ***-Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër***

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër ndodhet në dy godina, godina A dhe godina B, të cilat janë dy katëshe. Në katin e parë të Godinës B gjenden dhomat, ku janë të sistemuar të moshuar me probleme shëndetësore.

Ambientet e këtij institucioni, janë shumë komode dhe kudo mbizotëron pastërtia. Në një ambient të veçantë janë të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, si dhe “*kutia e ankesave*”, ku depozitohen ankesat e të moshuarve.

“*Kutia e ankesave*” hapet një herë në muaj, nga përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Shkodër, në praninë e një të moshuari.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, janë të vendosura në çdo kat të godinave. Stafi është trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit. Godina është e pajisur me impjant për rastet e rënies së zjarrit, me shkallë dhe dyer emergjence si dhe tregues për këto dalje. Ka një plan të miratuar për veprimet e personelit dhe të moshuarve në këto raste.

Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes realizohej me Chillerr, të vendosura në çdo dhomë. Pulti për komandën e ajrimit mbahet nga personeli, ndërsa pult për komandën e ngrohjes dhe ftohjes kishte në çdo dhomë.

Në ambiente të ndryshme të godinës janë vendosur 6 kamera, filmimet e të cilave ruhen 1 muaj dhe menaxhohen nga drejtuesi i qendrës.

Ambienti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, industriale, të përshtatshme për përballimin e gatimit sipas numrit të përfituesve. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruhen në frigorifer.

Kuota ushqimore ishte në vlerën 360 lekë në ditë për çdo person që trajtohet në qendër<sup>4</sup>, e cila së fundmi ishte e pamjaftueshme për përfituesit për shkak edhe të ndryshimeve të reflektuara në çmimet e tregut dhe me inflacion galopant.

Oraret e vakteve të ngrënies, merret mendimi i të moshuarve. Menyja javore përcaktohet nga të moshuar, kujdestarë, punonjësja sociale, mjeku dhe kuzhinierja, sipas mendimit të të moshuarve.

Në këtë institucion është vendosur një ashensor tek godina B, për t'i ardhur në ndihmë të moshuarve, të cilët janë me probleme shëndetësore.

Për lehtësimin në lëvizje të të moshuarve, përgjatë korridoreve të çdo kati të godinave, janë të vendosura mbajtëse inoksi. Godina është e pajisur me tualete, të cilat janë edhe të përshtatura për të moshuarit me probleme shëndetësore.

Furnizimi me artikuj hotelerikë gjatë vitit 2022 ka qenë sipas nevojave. Monitorimi i standardeve për përfituesit kryhet nga Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të cilët e kishin monitoruar institucionin e të moshuarve Shkodër.

### ***-Jeta social-kulturore***

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni i marrë gjatë inspektimit, u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, etj.



Aktivitetet që zhvilloheshin ishin, lojrat e tavolinës, domino, letra, tema diskutimi, qepje, kopshtari, zbulurime të ambientit të shtëpisë të moshuarve, rritja e temave sociale, , koncert muzikor me këngë shqiptare dhe të huaja, të cilat ishin të pamjaftueshme në arritjen e qëllimit për ruajtjen e shëndetit mendor dhe më pas rehabilitimin e kësaj kategorie.

Gjithashtu, në këtë institucion ka ambiente argëtimi për të moshuarit: bibliotekë, sallë bilardoje, salla e veglave për ushtrimin fizik, salla e ndenjes, e cila është shumë komode dhe relaksuese për të moshuarit.

Po ashtu, oborri është i sistemuar me ambiente çlodhëse për të moshuarit, për organizimin e aktiviteteve të ndryshme, një nga të cilat do të zhvillohej me rastin e 1 Tetorit, Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve.

Nga intervistimi që patëm me të moshuarit ata ishin shumë të kënaqur nga shërbimi i gjithë stafit të këtij institucioni. Shumica e të moshuarve kanë vite që jetojnë në këtë institucion dhe ndihen si në shtëpinë e tyre.

### ***-Problematikat e konstatuara:***

-  Konstatohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standardeve të përkujdesit shoqëror, posaçërisht me kujdestarë me formim infermieri me kohë të plotë, pasi të moshuarit shfaqin probleme shëndetësore.
-  Konstatohet se në këtë institucion përfitojnë shërbime 11 (njëmbëdhjetë) të moshuar, të cilët janë me probleme të shëndetit mendor dhe puna e personelit, i cili kujdeset për ta, është më e vështirë për dhënien e shërbimeve për këtë kategori.

---

<sup>4</sup> Udhëzimi i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 02.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunistare të përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar.

- ✚ Një problem që vijon të mbetet shqetësues është edhe ai i mjekut me kohë të pjesshme, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë çdo ditë i pranishëm në qendër, të paktën 8 orë.
- ✚ Konstatohet si një problematikë, që ende ka mbetur pa zgjidhje, mungesa e një automjeti, i cili është i rëndësishëm jo vetëm për raste emergjente apo transportimin e të moshuarve për vizitat e mjekësore, por edhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.
- ✚ Konstatohet si një problematikë e rëndësishme pasja e ilaçeve përtej datave të parashikuara të skadencës në këtë institucion.
- ✚ Konstatohet se kuota ushqimore nuk është mjaftueshme për plotësimin e nevojave jetësore të të moshuarëve.

Sa më sipër, në funksion të jetesës së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore; duke marrë në konsideratë konstatimet e renditura më sipër, Avokati i Popullit gjykon se pavarësisht punës rigoroze të bërë në këtë institucion, kërkohet një angazhim i natyrshëm për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit e akomoduar në Institucionet Rezidenciale.

Për këtë qëllim, për t'iu përgjigjur nevojave të tyre dhe për një jetesë sa më dinjitoze për të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, në mbështetje të nenit 21, të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë, psikolog dhe mjek me kohë të plotë për të ofruar shërbim cilësor në shtëpinë të moshuar në shkodër në funksion të jetesës së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore fuqi.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për fillimin e procedurës për asgjësimin e të gjitha medikamenteve të cilat ju ka kaluar afati i përdorimit dhe zëvendësimin e tyre me medikamente të reja.
3. Marrjen e masave për shtesë në pagë sipas vështirësisë, për personelin që kujdeset për kategorinë e të moshuarve me probleme të shëndetit mendor.
4. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për larminë e ushqimit sipas produkteve të stinës, si dhe rritjen e kuotave ushqimore për të moshuarit.



Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**K O M I S I O N E R**

**AHMET PRENÇI**